



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 2985/1 Prot.

Vlorë më, 20.11.2025

VENDIM

Nr. 101, datë 20.11.2025

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË RI STDUDIMIT, BACHELOR NË "MENAXHIM SHËNDETI PUBLIK DHE KUJDES SHËNDETËSOR" PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027 NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja 'dh' dhe nenit 75 të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja 'ë' dhe nenit 59 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; neni 13, pika 22, neni 55 dhe 69 të Rregullores së Brendshme të UV-së; Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve" (i ndryshuar); VKM-së Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar; si dhe referuar propozimit të Fakultetit të Shëndetit përcjellë me shkresën nr. 1580 Prot., datë 07.11.2025; dhe relaconit të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakadematike, përcjellë me shkresën 2970 prot., datë 19.11.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.11.2025,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Kujdesit Shëndetësor, në Fakultetin e Shëndetit, për hapjen e programit të ri të studimit, Bachelor në "Në menaxhim shëndeti publik dhe kujdes shëndetësor", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakadematike dhe Drejtuesit e Fakultetit të Shëndetit.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

